



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

Nr. 430 Prot.

Tiranë, më 01.07.2019

U R D H Ë R

Nr. 23, datë 01/07/2019

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE
PERSONALE, GJATË PROCESIT ONLINE TË INSPEKTIMIT”
PËR INSPEKTORATET SHTETËRORE DHE VENDORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 9 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave dhe kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;


U R D H Ë R O J :

1. Miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë procesit online të inspektimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ky Urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI PËRGJITHSHËM

SHKËLOIM HAJDARI



RREGULLORE

PËR

**“MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE
SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE, GJATË
PROCESIT ONLINE TË INSPEKTIMIT”**

PËR

**INSPEKTORATET SHTETËRORE DHE VENDORE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

PËRMBAJTJA

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Neni 2 Baza Ligjore

Neni 3 Qëllimi

Neni 4 Përkufizime

Neni 5 Fusha e zbatimit

Neni 6 Parimet e sigurisë së informacionit të inspektimit

KREU II

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 7 Mbrojtja e të dhënave personale

Neni 8 Qëllimi i përpunimit

Neni 9 Kriteret e përpunimit të të dhënave personale

Neni 10 Rastet e dorëzimit të të dhënave

Neni 11 Përdoruesit e të dhënave të administruara në portalin unik “e-Inspektimi”

KREU III

TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 12 Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

Neni 13 Kërkesa për informacion

KREU IV

NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Neni 14 Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike

Neni 15 Detyrimi për informim mbi vlefshmërinë ligjore

KREU V

SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 16 Masat për sigurinë e të dhënave

Neni 17 Mbrojtja e pajisjeve elektronike

Neni 18 Përpunimi i të dhënave të administruara në portalin unik “e-Inspektimi”

KREU VI

SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 19 Masat administrative

Neni 20 Mbikëqyrja e masave dhe procedurave mbrojtëse

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21 Konfidencialiteti dhe besueshmëria

Neni 22 Detyrimi për bashkëpunim

Neni 23 Detyrimi për zbatim

Neni 24 Sanksionet

Neni 25 Hyrja në fuqi

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Rregullore, është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave personale të administruara, gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, nga inspektorët e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Baza Ligjore

1. Kjo Rregullore mbështetet në një legjislacion të gjerë, vendas dhe ndërkombëtar, për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilin bazohet kryerja e procesit online të inspektimit.
2. Aktet kombëtare janë:
 - a. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
 - b. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
 - c. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar;
 - d. Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";
 - e. Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
 - f. Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik";
 - g. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.08.2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-Inspektimi";
 - h. Urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 15, datë 07.05.2015, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit "e-inspektimi";
 - i. Urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 10.08.2018, "Për miratimin e Rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ";
 - j. Urdhrat, Udhëzimet dhe Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
3. Aktet ndërkombëtare janë:
 - a. Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;
 - b. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokollin nr. 11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998;
 - c. Direktivat 2002/58/EC dhe 95/46/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian;

- d. Konventa 108 e Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale”, ratifikuar me ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004;
- e. Protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës, “Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale”, ratifikuar me ligjin nr. 9287, datë 7.10.2004.

Neni 3

Qëllimi

Kjo Rregullore, ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, të administruara gjatë kryerjes së procedurës së inspektimit, në portalin unik të inspektimeve “e-inspektimi”. Ajo zbatohet për të gjitha të dhënat e administruara, gjatë veprimtarisë së inspektimit dhe/ose përpunuara nga përdoruesit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, në përputhje me Ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përpunimi i të dhënave duhet të bëhet në përputhje me Kushtetutën, Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ndryshuar, si dhe me qëllimin dhe parimet e inspektimit, duke mbrojtur interesin publik dhe interesat e ligjshme të personave fizikë dhe juridikë.

Ky akt nënligjor, përcakton kriteret e sigurisë për përdoruesit e autorizuar, me të drejtë akses në portalin unik “e-Inspektimi”.

Neni 4

Përkufizime

1. Në funksion të kësaj Rregullore, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
 - a. **“Të dhëna personale”**: është çdo informacion, që administrohet pranë Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me një person fizik, direkt ose indirekt, në veçanti duke ju referuar një numri identifikimi, ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij;
 - b. **“E dhënë anonime”**: është çdo e dhënë, e administruar pranë Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, që në origjinë ose gjatë përpunimit, nuk mund t’i shoqërohet një individ, të identifikuar ose të identifikueshëm;
 - c. **“Përpunim i të dhënave personale”**: është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash;
 - d. **“Subjekt i të dhënave”**: është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale;

- e. **“Kontrollues”**: Për efekt të kësaj Rregullore është Inspektorati Qendror, i cili vetëm apo së bashku me të tjerë, në përmbushje të detyrimeve ligjore, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligj;
- f. **“Përpunues”**: Për efekt të kësaj Rregullore janë punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, përveç punonjësve të kontrolluesit, që përpunojnë të dhëna personale, të administruara nëpërmjet procedurës inspektuese;
- g. **“Marrës”**: është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, të cilit i janë dhënë të dhënat e një pale të tretë ose jo.
- h. **“E drejtë informimi”** dhe **“Programe të Transparencës”**: kanë kuptimet sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;
- k. **“e-Inspektimi”**: ka kuptimin sipas përcaktimit në Urdhrin nr. 15, datë 07.05.2015, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-inspektimi”;
- i. **“Nënshkrim elektronik”**: është një mjet verifikimi elektronik, i cili zakonisht përcaktohet si verifikim i identitetit të zotëruesit. Çdo lloj verifikimi elektronik do të konsiderohet si nënshkrim elektronik, për sa kohë ai është i lidhur me të dhëna të tjera në formë elektronike.
2. Termat e tjerë të përdorur në zbatim të kësaj Rregullore, do të kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike dhe elektronike, që janë në funksion të procedurës inspektuese dhe që administrohen në portalin unik “e-Inspektimi”.

Neni 6

Parimet e sigurisë së informacionit të inspektimit

Inspektorët e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor për kryerjen e procedurës inspektuese, si një proces i rregullt administrativ, duhet të respektojnë parimet mbi sigurinë e informacionit të administruar, nëpërmjet procesit të inspektimit, si më poshtë:

- Parimi i integritetit, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;
- Parimi i konfidencialitetit, duke siguruar që të dhënat e administruara nëpërmjet procedurës inspektuese të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;
- Parimi i besueshmërisë, duke garantuar që çdo veprim i tyre mbi të dhënat, është i kontrollueshëm.

KREU II

PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave personale

Çdo punonjës i Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës inspektuese, ka detyrimin të zbatojë kërkesat e neneve 2 dhe 5, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2018, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si më poshtë:

1. Respektimin e parimit për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;
2. Kryerjen e përpunimit të të dhënave personale në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
3. Grumbullimin e të dhënave personale për qëllime specifike, legjitime e të përcaktuara qartë, si dhe kryerjen e përpunimit të tyre në përputhje me këto qëllime;
4. Mbajtja e dokumentacionit të inspektimit nga personi/personat e autorizuar për çështjet inspektuese.
5. Të dhënat që do të përpunohen duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin legjitim të përpunimit dhe të inspektimit, si dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
6. Të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin dhe përfaqësimin e nevojshme për procesin online të inspektimit dhe jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë administruar.
7. Marrja e masave për të shmangur rastet e incidenteve, që mund të shkaktojnë shkeljen e sigurisë së të dhënave, të administruara në pajisjet Tablet për inspektimin, dhe në portalin elektronik “e-Inspektimi”.

Neni 8

Qëllimi i përpunimit

Çdo inspektor i Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore në Republikën e Shqipërisë, i cili në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjet organike dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tyre, si dhe vihet në dijeni me të dhëna personale, të dhëna që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale të subjekteve, ka detyrimin e përpunimit të drejtë e të ligjshëm të tyre, si dhe të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre, në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 9

Kriteret e përpunimit të të dhënave personale

1. Inspektorët e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, që përpunojnë të dhëna personale të subjekteve, të administruara gjatë veprimtarisë inspektuese, në portalin unik “e-inspektimi”, bazohen në kriteret e përcaktuara në nenin 6, të Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2. Të dhënat personale përpunohen nga ana e inspektorit, vetëm me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për kryerjen e inspektimeve online, si një proces i rregullt administrativ, i cili brenda kuadrit ligjor, duhet të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duhet të kontribuojë në realizimin e tyre.

Neni 10

Rastet e dorëzimit të të dhënave

Personi i autorizuar me të drejtë akses në portalin unik “e-Inspektimi”, lidhur me të dhënat e administruara në portal, gjatë procesit online të inspektimit në subjektin, objekt inspektimi, i dorëzon një Autoriteti, me kërkesë të këtij të fundit, të dhëna për aktet e mbajtura në subjekt, si dhe prova të administruara me video, audio dhe foto nga trupa inspektuese, në rastet si më poshtë:

- a) kur kjo është e nevojshme, gjatë shqyrtimit të ankimimit të subjektit nga trupa kolegjiale pranë Inspektorateve Shtetërore, ose gjatë shqyrtimit të ankimimit të subjektit në gjykatë;
- b) kur kjo është e nevojshme, për ndjekjen e veprave penale ose të shkeljeve ligjore dhe kur një kërkesë e tillë vjen nga organet e ngarkuara me ligj për hetimin e tyre;
- c) për të shmangur rrezikun, që i kanoset sigurisë kombëtare ose rendit publik;
- d) për të kryer detyrat, që u ka ngarkuar ligji autoriteteve në hetimin e shkeljeve ligjore;
- e) kur një gjë e tillë e vendos gjykata.

Neni 11

Përdoruesit e të dhënave të administruara në portalin unik “e-Inspektimi”

Përpunuesit e të dhënave të administruara në portalin unik “e-Inspektimi”, gjatë veprimtarisë së inspektimit:

1. Sigurojnë se materialet e administruara gjatë veprimtarisë inspektuese në subjekt, si dhe fotot, videot dhe audiot, nuk mund të ruhen/përdoren jashtë qëllimeve të përcaktuara në ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Të dhënat e administruara gjatë veprimtarisë së inspektimit në subjekt, nuk mund të aksesohen nga përdorues të paautorizuar.

3. Përfshihen mundësinë e ndërhyrjeve në procedurën e inspektimit me qëllim tjetërsimin e të dhënave të administruara në portal gjatë veprimtarisë inspektuese në subjektin, objekt inspektimi.

KREU III

TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 12

Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

1. Përhapja ose komunikimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin janë grumbulluar këto të dhëna.

2. Kërkuesi i informacionit, ose personi i autorizuar prej tij, ka të drejtë që të njihet me të dhënat e administruara gjatë veprimtarisë inspektuese nga trupa inspektuese, nëpërmjet një kërkesë drejtuar Inspektoratëve Shtetërore dhe/ose Vendore.

3. Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore kanë detyrimin që në bazë të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të zbatojnë këto të drejta të subjekteve të të dhënave personale:

a. të drejtën për të kontestuar;

b. të drejtën për t'u ankuar.

4. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar identitetin e kërkuesit. Kërkesa mund të administrohet pranë Inspektoratit Shtetëror ose Vendor, në formë postare, ose nëpërmjet faqes zyrtare. Inspektorati Shtetëror ose Vendor, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Neni 13

Kërkesa për informacion

Kërkesën për informacion mund ta bëjë:

1. Vetë personi;

2. Përfaqësuesi ligjor, i pajisur me autorizimin përkatës;

3. Persona të tjerë, të cilët megjithëse nuk kanë interes të drejtpërdrejtë, provojnë se kanë një interes të ligjshëm për të marrë dijeni mbi këto të dhëna dhe që përputhet me qëllimin e grumbullimit të këtyre të dhënave. Dhënia e informacionit, në këtë rast, bëhet në mënyrë të tillë dhe për aq sa nuk cenohen të drejtat e subjektit të të dhënave, në përputhje me parimet e sanksionuara në Ligjin nr. 9987/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

KREU IV

NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Neni 14

Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike

Dokumenti elektronik, "Procesverbal Inspektimi", i cili mban emrin e nënshkruesit inspektor/ët, subjektit ose përfaqësuesit të tij dhe nënshkrimet e tyre të kualifikuara, kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.

Neni 15

Detyrimi për informim mbi vlefshmërinë ligjore

Inspektori i Inspektoratit Shtetëror dhe/ose Vendor, si përfaqësues i nënshkrimit elektronik të dokumenteve të mbajtura në portalin unik "e-inspektimi", informon subjektin se nënshkrimi elektronik i kualifikuar në veprimet juridike dhe aktet e mbajtura, kanë të njëjtën vlefshmëri sikurse edhe nënshkrimi në formë shkresore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligjin për nënshkrimin elektronik.

KREU V

SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 16

Masat për sigurinë e të dhënave

1. Inspektoratet Shtetërore dhe Vendore, në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërtime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në portalin unik "e-Inspektimi", si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Platforma unike "e-Inspektimi" mbështetet në infrastrukturën mbrojtëse, që ofron sistemi GovNet, i cili administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit". Kjo do të thotë që platforma "e-Inspektimi", mbështetet tek mekanizmat e mbrojtjes së trafikut të rrjetit që ka GovNet, në filtrimet e kodit me qëllime keqdashëse të GovNet dhe në mekanizmat e tij për mbrojtjen nga ndërhyrjet apo sulmet e jashtme.

3. Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, pa përjashtim, udhëzohen për detyrimet që kanë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, aktet nënligjore, si dhe Rregulloren “Për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë procesit online të inspektimit”.

4. Ndalohet përdorimi i paautorizuar i pajisjeve Tablet, të cilat janë vetëm në funksion të kryerjes së procesit online të inspektimit.

5. Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore nuk duhet të lënë në vende të pasigurta pajisjet Tablet apo pajisje të tjera, të cilat janë në funksion të procedurës inspektuese.

6. Të dhënat personale mbrohen, duke verifikuar identitetin e përdoruesit dhe duke i lejuar akses vetëm individëve të autorizuar.

7. Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, kryejnë vazhdimisht procedurën e hyrjes dhe daljes në portalin unik të inspektimeve “e-inspektimi”, duke përdorur fjalëkalime personale.

8. Të dhënat e dokumentuara, nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit/inspektimit.

9. Dokumentacioni fizik dhe elektronik, ruhet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

10. Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore, respektojnë aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që përcaktojnë se si duhet të përdoren të dhënat personale.

Neni 17

Mbrojtja e pajisjeve elektronike

Pajisjet elektronike për kryerjen e procedurës inspektuese, si dhe përpunimin e të dhënave dhe informacioneve lidhur me inspektimin, përdoren vetëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligjin dhe aktet nënligjore mbi inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe në këtë rregullore. Këto pajisje përdoren vetëm nga personat e autorizuar të Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore.

Neni 18

Përpunimi i të dhënave të administruara në portalin unik “e-inspektimi”

1. Të dhënat e administruara në portalin unik “e-inspektimi”, përbëjnë të dhëna personale, kur një individ mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi në bazë të regjistrimeve. Në çdo rast, nëse administrohen të dhëna të tilla, ato do të konsiderohen të ligjshme nëse janë në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6, të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2. Të dhënat identifikuese nëpërmjet pajisjes Tablet, me foto, video & audio rekorder, mund të lejohen vetëm nëse qëllimi i inspektimit nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër.

3. Qëllimi i fotografimit dhe regjistrimit nëpërmjet sistemit “video & audio rekorder”, duhet të jetë vetëm për realizimin e procedurës inspektuese, brenda kuadrit ligjor mbi inspektimin. Fotografimet, regjistrimet video dhe audio rekorder, mund të përdoren vetëm në funksion të kryerjes së procedurës online të inspektimit.

4. Masat e sigurisë duhet të jenë të tilla në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese, në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesit i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

5. Ndalohet përhapja e imazheve të përfituara nëpërmjet pajisjes Tablet, gjatë ushtrimit të procedurës online të inspektimit.

KREU VI

SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 19

Masat administrative

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, i cili shkel detyrimin për të mbrojtur të dhënat personale është përgjegjës për thyerje të disiplinës, rregullave, dhe detyrimeve në veprimtarinë e punës së tij. Në qoftë se veprimet e tyre nuk përbëjnë veprë penale, ndaj tyre merren masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.

Neni 20

Mbikëqyrja e masave dhe procedurave mbrojtëse

Mbikëqyrja e implementimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale për respektimin e normave të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale, ose të paautorizuar, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe përhapjes së paautorizuar të tyre, realizohet nga personat përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të dhënave respektive.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Konfidencialiteti dhe besueshmëria

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, që përpunon të dhëna apo vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara, nuk mund të bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave, personave të tjerë.

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, i cili ka akses në të dhënat personale të administruara në portalin elektronik “e-Inspektimi”, ka detyrimin e mbrojtjes, ruajtjes, mospërhapjes së këtyre të dhënave, gjatë dhe pas mbarimit të detyrës.

Personat e autorizuar me të drejtë akses në të dhënat personale të administruara në portalin unik “e-Inspektimi” me foto, video dhe audio, duhet të ushtrojnë detyrën funksionale duke respektuar dhe garantuar parimin e besueshmërisë.

Neni 22

Detyrimi për bashkëpunim

Punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore duhet të jenë të ndërgjegjshëm për detyrimin që kanë për të bashkëpunuar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për t'i siguruar të gjithë informacionin, që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, që i janë ngarkuar sipas nenit 29 të ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Neni 23

Detyrimi për zbatim

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të detyrueshme për zbatim nga punonjësit e Inspektorateve Shtetërore dhe Vendore.

Çdo punonjës që merret me përpunimin e të dhënave personale është i ndërgjegjshëm se përpunimi i të dhënave personale në kundërshtim me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative.

Neni 24

Sanksionet

Kjo Rregullore është pjesë e akteve nënligjore mbi inspektimin dhe mosrespektimi i kërkesave të saj përbën shkelje të disiplinës në punë dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.